

UDHËZIM
Nr.6, datë 19.1.2009

**PËR PARALAJMËRIMIN E LOJTARËVE DHE EKSPOZIMIN E LOJRAVE TË FATIT
NDAJ INSTITUCIONEVE FETARE, SHËNDETËSORE DHE ARSIMORE**

Në mbështetje të nenit 102/4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe në zbatim të nenit 7 pika 3 të ligjit nr.10033, datë 11.2.2008 “Për lojrat e fatit” Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Në mjedisin ku luhen lojërat e fatit duhet të ekspozohet gjithmonë një tabelë e dukshme, paralajmëruese për lojtarët me këtë përmbajtje:

a. “Marrja pjesë në lojërat e fatit mund të ndikojë negativisht në gjendjen ekonomike të lojtarit”.

2. Hyrja në mjediset ku zhvillohen loja fati ose reklamimi i vendosur jashtë ambjenteve ku zhvillohen këto loja:

a. Duhet të jenë jo më afër se 40 metra nga godinat e institucioneve arsimore, shëndetësore ose fetare apo hyrja për në këto institucione, me kusht që këto institucione të jenë përballë mjediseve ku zhvillohen lojëra fati dhe të ekspozuara (shihen lirshëm pa pengesa) ndaj tyre;

b. Duhet të jenë jo më afër se 15 metra nga hyrja për në institucionet arsimore, shëndetësore ose fetare në rastet kur reklama apo hyrja për në mjediset ku luhen loja fati ndodhet në të njëjtën rrugë që të çon në hyrjen e institucioneve arsimore, shëndetësore ose fetare.

c. Nuk mund të jenë në të njëjtën rrugë që të çon në institucione arsimore, shëndetësore apo fetare në rast se rruga (për këmbësorë ose automjete) që të çon në këto institucione është e vetme.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode